

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Egian by Intermedica”Shpk**

Ortakët themelues:

1. **Shoqëria “Intermedica Center” shpk** themeluar me datë 21/05/1996 dhe regjistruar me date 06/03/2003 me numër Nipt K31513084W me adresë kryesore : Njesia administrative nr 9, Rruga Jordan Misja, Zona Kadastrale nr 8330, Nr Pasurie 8/416-N9, 8/416-N7, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Thoma Vasili me numër Karte Identiteti J11124074J, banues në Tiranë

2. Fatos Mollosmani i datëlindjes 25.09.1970, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë me numër Karte Identiteti H00925053L.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 25.07.2022 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

**NENI 1**

**Emri**

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin **“Egian by Intermedica” shpk**.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

**NENI 2**

**Forma**

2.1 Shoqëria tregtare **“Egian by Intermedica” shpk**, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

**Zyra Qendrore**

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“Egian by Intermedica” shpk** do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Rruga e Kavajes, Qendra Condor, kati perdhe. Tirane.

**NENI 4**

**Objekti i Veprimtarisë**

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në fushën e shërbime të analizave mikrobiologjike, kimike, hormonale, bakterologjike, molekulare dhe gjenetike.

Ushtrimi aktivitetit diagnostikues dhe kurues, kurimi semundjeve në kushte ambulatorie, organizim të shërbimit të urgjencës, diagnoza me imazhe etj.

Organizon trajnime profesionale për llogari të vet dhe / ose për llogari të treta.

#### **NENI 5**

##### **Kohëzgjatja**

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë *“Egion by Intermedica” Shpk* do të jetë me afat të pacaktuar.

#### **NENI 6**

##### **Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

6.1 Shoqëria tregtare *“Egion by Intermedica” Shpk* mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### **NENI 7**

##### **Përgjegjësia e Ortakëve**

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë *“Egion by Intermedica” Shpk* dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

#### **NENI 8**

##### **Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat**

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar *“Egion by Intermedica” Shpk* është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

1- *“Intermedica Center” shpk* me Nipt K31513084W është zotëues i 1 (një) kuote e cila përbën 45 % të kapitalit të shoqërisë.

2- Zt. Fatos Mollosmani është zotëues i 1 (një) kuote e cila përbën 55 % të kapitalit të shoqërisë.


#### **NENI 9**

##### **Organet e Shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.



## NENI 10

### **Administratori**

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 3(tre)vjet. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është zt.Fatos Mollosmani mbajtes i kartes se identitetit me nr H00925053L.

Administrator i Shoqërisë është zt, Fatos Mollosmani i datëlindjes 25.09.1970, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë.

**Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.**

### **ORTAKËT**



#### **E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR**

*“Egian by Intermedica” Shpk*

Shoqëria “**Intermedica Center**” sh.p.k..

*Perfaqesuar nga administratori*

**Thoma Vasili**



**Fatos Mollosmani**

